



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 2051 Prot.

Tiranë, më 13.08.2025

Lënda: Për zhvillimin e praktikës profesionale në profesionin e rregulluar të mësuesit për vitin mësimor 2025-2026.

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në zbatim të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 14, datë 10.07.2023 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punjonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”, i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 100, datë 25.02.2022, “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”, i ndryshuar, shkresës 2319/1, datë 04.04.2024, të MAS “Për praktikën profesionale”, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP), drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar zhvillojnë procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikës profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. Kandidatët që do të pranohen në praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit janë të gjithë ata kandidatë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Profili ku kandidati do të kryejë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit lidhet me programin e studimit të ciklit të parë dhe/ose të ciklit të dytë që ka përfunduar kandidati.

Për vitin shkollor 2025-2026 aplikimi për zhvillimin e praktikës profesionale për ushtrimin e profesionit të rregulluar të mësuesisë do të kryhet nëpërmjet platformës e-Albania.

Kandidatët kanë të drejtë të zhvillojnë praktikën profesionale në një nga tri periudhat mësimore.

Afati i regjistrimit të kandidatëve që do të zhvillojnë praktikën profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit, nëpërmjet platformës e-Albania, është si vijon:

- Për periudhën e parë mësimore: nga data 20.08.2025 deri më 30.08.2025
- Për periudhën e dytë mësimore: nga data 01.12.2025 deri më 12.12.2025
- Për periudhën e tretë mësimore: nga data 02.03.2026 deri më 13.03.2026

Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, brenda 7 (shtatë) ditëve pas mbylljes së aplikimit të secilës periudhë, dërgon në format Excel, në DRAP-in përkatës, listën e praktikantëve të asaj periudhe, sipas tabelës së dërguar në format elektronik nga AKAP.

Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, 7 (shtatë) ditë pas marrjes së listave nga ZVAP-i nën juridiksionin e saj, harton listën përfundimtare me kandidatët aplikantë të periudhës përkatëse në format excel dhe ja dërgon në Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 7 (shtatë) ditë pas marrjes së listave nga DRAP-et, dërgon listat përfundimtare të kandidatëve të periudhës përkatëse, zyrtarisht me postë dhe në rrugë elektronike në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar publikojnë në faqet e tyre zyrtare të internetit listën e IAPP-ve, publike dhe/ose private, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale, në të tri fazat e aplikimit.

Praktikanti paraqitet në IAPP për të filluar praktikën profesionale në periudhën që ka aplikuar pas pranimit dhe lajmërimit nga ZVAP.

ZVAP-et janë përgjegjëse për saktësinë e të dhënave të pasqyruara në tabelën e dërguar në DRAP-e si dhe për respektimin me rigorozitet të kërkesave dhe të afateve të përcaktuara si më sipër.

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të praktikës profesionale është objekt monitorimi nga Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Rezarta ALLA

